



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Prill 2022

Nr: 152

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE”, NDAJ
DREJTORIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “ARMATH” DHE KANDIDATIT PËR
KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË DURRËS ZJ. EMIRIANA SAKO, PROPOZUAR
NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 28 Prill 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

Kërkues: Organizata “Qendresa Qytetare”

Objekt: Takim elektoral në ambientet e jashtme të Shkollës Armath, Durrës në kundërshtim me kufizimet e Kodit Zgjedhor

Ndaj: Drejtorit të Shkollës 9- Vjeçare “Armath”
Kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë Durrës zj. Emiriana Sako

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, 91, 92, 171, pika 1, dhe 172, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive

Data: 28 Prill 2022

Nr. 152

“Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj Drejtorit të Shkollës 9-Vjeçare “Armath” dhe kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë Durrës zj. Emiriana Sako, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”



dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

V Ë R E N:

I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 1 Mars 2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së është raportuar denoncimi me numër ID unik 3646, për kryerjen e një takimi elektoral me banorët e Njesisë Administrative Manëz, bashkia Durrës në ambientet e Shkollës 9-vjeçare Armath, ku pretendohet se: *“Në datë 25.02.2022, në fshatin Armath të Manzës, konkretisht në ambientet e jashtme të Shkollës Armath, Kandidatja e Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetare në bashkisë Durrës, zj. Emiriana Sako, me pjesëmarrjen edhe të deputetëve të zonës, ka pritur në një takim elektoral banorët e Njesisë Administrative Manëz. Gjatë këtij takimi sikurse vërehet nga statusi në profilin personal në “Facebook” të kandidatës, zj. Emiriana Sako, por edhe nga mediat, në këtë takim është bërë promovimi i investimeve vendore në atë zonë duke përfshirë procesin e rindërtimit por edhe vetë rikonstruktimin e Shkollës Armath, ku po zhvillohej takimi në fjalë. Ky aktivitet vjen në një kohë, që përkon me fushatën zgjedhore, në referim të vendimit nr. 2, pika 2 datë 22.01.2022 i Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur qartazi nenin 91, pasi nuk mund të përdoren ose vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime (astet) të oganeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, gjithashtu edhe në referim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Oborri, si ambient i jashtëm gjithashtu është pjesë integrale e institucionit arsimor në fjalë dhe si i tillë është një aset publik. Po ashtu në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultojnë një takim i raportuar nga bashkia Durrës, i cili i referohet një takimi në datë 24.02.2022, banorët e fshatit Armath, i cili nuk përmbush kriteret e parashikuara nga neni 92 i Kodit Zgjedhor për sa i përket elementëve si lloji dhe tematika e takimit”.*



- Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar pamjet fotografike nga takimi dhe të ambienteve të Shkollës 9-vjeçare “Armath”.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.
 3. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
 - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
 - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
 - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
 4. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.
 5. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
 6. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga denoncuesi “Qendresa Qytetare”, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

7. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, nuk lejojnë përdorimin e burimeve të organeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve gjatë fushatës elektorale. Në zbatim



të këtyre dispozitave është miratuar edhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator mbi “Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në denoncimin e mësipërm pretendohet se, është kryer një takim elektorale që bie në kundërshtim me nenet 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor, si dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në kuadër të hetimit administrative me shkresën nr. 1375 prot., datë 02.03.2022, i është drejtuar zj. Emiriana Sako, me shkresën nr. 1376 prot., datë 02.03.2022 Drejtorit të Shkollës 9- Vjeçare Armath, si dhe me shkresën nr. 1602 prot., datë 06.03.2022, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” duke i kërkuar, informacion sqarues në lidhje me denoncimin e bërë nga organizata “Qendresa Qytetare” në lidhje me organizimin e këtij takimi. Nëpërmjet shkresës nr. 689 prot., datë 05.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1479 prot., datë 09.03.2022, jemi informuar nga Drejtori i Shkollës 9- vjeçare Armath, z. Vlash Doda, në lidhje me organizimin e takimit në oborrin e shkollës, sipas së cilit pretendohet se, “*Institucioni i Bashkisë Durrës ka raportuar sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin e aktivitetit në orën 17:00. Raportimi nuk është refuzuar, mos pranuar apo tërhequr vëmendje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe si i tillë konsiderohet i pranuar dhe i vlefshëm po aq sa ligjërisht i rregullt dhe pa të meta. Takimi është zhvilluar përtej orarit mësimor dhe pa pjesëmarrjen e nxënësve*”.
9. Nëpërmjet shkresës me nr. 2187/1 prot., datë 09.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1375/1 prot., datë 9.03.2022, jemi informuar nga Bashkia Durrës se, “*Raportimi i takimit është kryer në ndarëfaqen e KQZ në datën 21.02.2022 dhe ka si vendndodhje të takimit fshatin Armath. Për shkak të kushteve atmosferike, nga momenti i raportimit deri në momentin e takimit, u bë spostimi i vendndodhjes nga sheshi në fshatin Armath (ku ishte e pamundur të mbahej takimi për shkak të terrenit të rënduar) në sheshin pranë shkollës, por jo në oborrin e shkollës... në takim është trajtuar problematika e rindërtimit që lidhet me emergjencën dhe vazhdueshmërinë e një procesi i cili varet nga ndërthurja e punës dhe aktivitetit të një sërë institucioneve dhe jo vetëm bashkisë Durrës*”.
10. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1836 prot., datë 28.03.2022, përcjell për njohje gjetjet e denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj Kandidates për kryetare bashkie të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, drejtorit të shkollës



9-vjeçare Armath, si dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të vendimit nr. 9 datë 6.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, palët në proces, janë njoftuar për të paraqitur prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.

11. Brenda afatit të përcaktuar Organizata “Qendresa Qytetare” nëpërmjet shkresës administruar me tonën nr. 1921 prot., datë 28.03.2022, paraqiti prapësime në lidhje me denoncimin e pretenduar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2124 prot., datë 11.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 13 Prill 2022, ora 13:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj Kandidates për kryetare bashkie të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, drejtorit të shkollës 9-vjeçare Armath.
12. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti, e autorizuar nëpërmjet shkresës datë 11.04.2022, e administruar si dokument gjatë seancës dëgjimore, z. Arben Isaku, me detyrë drejtor i drejtorisë ligjore në Bashkinë Durrës, e autorizuar nëpërmjet shkresës nr. 2350/1 prot. datë 15.03.2022 të Bashkisë Durrës dhe z. Vlash Doda me funksion drejtor i shkollës 9-vjeçare “Armath”, Durrës. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkoi përfaqësuesit të organizatës “Qendresa Qytetare”, të parashtojë pretendimet e tij në lidhje me denoncimin.

Pretendimet e palëve:

- Në shpjegimet e tij përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare”, konfirmoi edhe njëherë denoncimin e raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke deklaruar se drejtori i shkollës “Armath” nëpërmjet shkresës nr. 689 prot., datë 05.03.2022, ka pranuar dhe pohuar se aktiviteti është zhvilluar në ambientet e institucionit në fjalë. Vërehet një mosrakordim i deklarimeve sa i përket vendit ku është zhvilluar takimi, ku drejtori pranon zhvillimin e takimit. As bashkia Durrës dhe as z. Vlash Doda, nuk i mbështesin pretendimet e tyre në këtë proces, pasi bashkia Durrës në pretendimet që ngreh nuk del qartë arsye se përse duhet të zhvendosej ky takim në ambientet e shkollës, duke mos dhënë asnjë provë apo shpjegim të arsyeshëm se përse ky takim duhej të zhvillohej në këto ambiente. Sa i përket referimit të kushteve atmosferike, pamjet e fotove të vëna në dispozicion duket se janë mjaft të favorshme për zhvillimin e aktivitetit.
- Në shpjegimet e tij përfaqësuesi ligjor i bashkisë Durrës, z. Isaku, deklaroi se për shkak të kushteve atmosferike emergjente na është komunikuar që mbledhja do të zhvillohet në ambientet e shkollës Armath. Në të janë trajtuar çështjet e rindërtimit, emergjencat dhe pretendimi ynë është që ky aktivitet nuk është në kushtet e ndalimeve të parashikuara nga neni

91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 pasi problematikat që trajtohen nuk futen në fushën e veprimit të këtij neni. Është bërë afër shkollës, jo brenda saj dhe sikur pretendimi të jetë i mirëqënë, është bërë jashtë orarit mësimor. Kjo shkollë ka statusin e qendrës komunitare.

- Në shpjegimet e tij drejtori i shkollës 9-vjeçare “Armath”, z. Vlash Doda, deklaroi se aktiviteti është zhvilluar në orën 17:30, pas orarit zyrtar të mësimin, jashtë ambienteve të shkollës, në një kohë që aty janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera të qendrës komunitare, jo në oborrin e shkollës, jashtë saj, ambient i lirë por jo i shkollës. Për arsye të kushteve atmosferike na është kërkuar nga përfaqësuesit e Njesisë së Qeverisjes vendore për ta zhvilluar aty dhe kështu është bërë. Në lidhje me orarin, është bërë jashtë procesit mësimor, pa pjesëmarrjen e nxënësve.
13. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi dëgjoi palët në proces, përfundoi shqyrtimin në tërësi dhe hetimin administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare. Zj. Kurti në përfundim të procesit administrativ i qëndroi prapësimeve të paraqitura më parë dhe i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve: konstatimin e shkeljeve dhe vendosjen e sanksioneve bazuar në nenin 172 të Kodit Zgjedhor. Z. Isaku në përfundim të procesit administrative i qëndroi pretendimve të tij duke deklaruar se denoncimi është bërë pa arsye, shkolla është përdorur si qendër komunitare ku zhvillohen aktivitete, si arsye pse veprimtaria është zhvilluar këtu, për shkak të kushteve atmosferike, që e kanë detyruar spostimin, jo se është përdor shkolla komunitare për këtë qëllim. Z. Doda, drejtor i shkollës 9-vjeçare “Armath”, në përfundim të procesit administrativ deklaroi se konstatimet e ngritura nga pala tjetër nuk qëndrojnë plotësisht pasi aty është zhvilluar një aktivitet elektoral por jo brenda ambienteve të shkollës.

III. Analiza ligjore

14. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se në kuptim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor i cili parashikon se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer në ambientet e Shkollës 9-vjeçare Armath, është një veprimtari me karakter publik pasi ka pasur pjesëmarrjen e publikut dhe të mediave. Referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se, *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”*.



15. Nga materialet e dosjes hetimore dhe nga të dhënat e marra nga ndërfaqja e raportimit, rezultoi se aktiviteti është kryer në datën 24.02.2022, ora 17:00, me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe me folës kryesor, Kryetarin e Bashkisë Durrës zj. Emirana Sako. Raportimi i kryer në datën 21.02.2022 në ndërfaqen “Aktivitetet e raportuara”, në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit “Fshatin Armath” **pa përcaktuar vendndodhjen e saktë të takimit**. Rezultoi e provuar se veprimtaria me karakter elektoral është kryer në ambientet rrethuese të një institucioni publik, ashtu si është dhe “Shkolla 9-vjeçare Armath”.
16. Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator parashikojnë detyrimin për raportim vetëm të institucionve publike për veprimtaritë me karakter publik. Në këtë aspekt, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson të rëndësishme të sqarojë se, bashkia Durrës nuk ka pasur detyrimin për raportim të këtij aktiviteti, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me një takim elektoral dhe jo aktivitet të institucionit të Bashkisë Durrës, vërtetuar kjo nga materialet propagandistike të vendosura në aktivitet për promovimin e fushatës së kandidatit për kryetar bashkie. Kryetari në detyrë i bashkisë duhet të ndajë veprimtarinë institucionale në cilësinë e kryetarit si bartës i funksioneve publike, me atë si kandidat për kryetar. Në këtë kuptim, në rast se kryetari i bashkisë në detyrë, por njëkohësisht dhe kandidat për kryetar bashkie, kryen një takim elektoral, nuk duhet ta raportojë atë si aktivitet publik të institucionit. Ndërfaqja “aktivitetet e raportuara” është krijuar si një formë për raportim **vetëm për institucionet publike** dhe veprimtarinë e tyre, në mënyrë që të kryhet një vlerësimi paraprak nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mos keqpërdorim të fondeve publike në periudhë zgjedhore.
17. Nenit 91, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”* Komisioni Rregullator, në vendimin nr. 9/2020 në nenin 3, pika 1.3, nëndarja c, qartësisht ka përcaktuar se *“veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: “vënien në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësisve të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron*

kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”.

18. Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se Drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Armath” z. Vlash Doda, në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor **ka vënë në dispozicion** të kandidatit për kryetar bashkie të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” zj. Emiriana Sako, ambientet e shkollës për zhvillimin e takimit elektoral.
19. Rezultoi e provuar gjithashtu se zj. Emiriana Sako, kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, e propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me zhvillimin e fushatës elektroale në ambientet e Shkollës 9-vjeçare Armathë, **ka përdorur burime publike** në mbështetje të fushatës së saj zgjedhore.
20. Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ku parashikohet se *“shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”* dhe pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, vlerëson se Drejtori i Shkollës 9-vjeçare Armath, z. Vlash Doda është në shkelje të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
21. Në kuptim të pikës 20, të nenit 2, të Kodit Zgjedhor “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe **kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore**, të regjistruar në përputhje me këtë Kod. Referuar pikës 1, të nenit 172, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se, *“Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se zj. Emiriana Sako, si subjekt zgjedhor në cilësinë e kryetarit të bashkisë dhe njëkohësisht kandidat për kryetar bashkie, në bashkinë Durrës, ka kryer takim elektoral në ambientet rrethuese të Shkollës “Armath”, Durrës, në shkelje të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91, 92 ,171, pika 1 dhe 172, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

VENDOSI:

1. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj Drejtorit të Shkollës 9- Vjeçare “Armath” z. Vlash Doda në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë.
2. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë Durrës, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Emiriana Sako në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 28 Prill 2022

Nr. 152

“Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj Drejtorit të Shkollës 9-Vjeçare “Armath” dhe kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë Durrës zj. Emiriana Sako, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”